



Kingdom of the Netherlands



DOKUMENT POLITIKASH

## **Prokurimi Publik**

# **Shqipëria në Lupën e Integritit Evropian**

Shkurt, 2022

Ky dokument u realizua nga AIS me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Hollandës në kuadër të projektit C1-EU-NPA



Dokumenti i Politikave me titull *Prokurimet Publike, Shqipëria në Lupën e Integritimit European* është hartuar nga organizata Albanian Institute of Science AIS/Open Data Albania, në zbatim të projektit *C1 – EU – NPA “Përmirësimi i Debatit mbi Politikën dhe Llogaridhënieën për të Përbushur të Drejtat Bazike”*, përmes krijimit të Platformës së Negociatave të Cluster 1 Shqipëri. Projekti zbatohet nga katër organizata shqiptare: Center for the Study of Democracy and Governance CSDG, Instituti i Studimeve Politike ISP, Komiteti Shqiptar i Helsinkit KSHH dhe Albanian Institute of Science AIS, me mbështetje të Ambasadës së Mbretërisë së Hollandës në Tiranë.

Dokumenti i politikave **“Prokurimet Publike në Lupën e Integritimit European”** u prezantua në Tiranë si pjesë e Iniciativës Shkurti 2022: Muaji i Integritimit European, përmes angazhimit të Shoqërisë Civile.

Gjetjet, Opinionet apo Rekomandimet e shprehura në këtë event përfaqësojnë këndvështrime të ekspertëve dhe organizatës AIS dhe nuk përkohet me përgjegjësi të partnerëve apo mbështetësve të Projektit C1-EU-NPA.



## Hyrje

Kjo temë është nuk është e re në Shqipëri, por ka rëndësi gjithnjë e më të madhe për shkak të faktit se sektori publik - domethënë shteti, - nëpërmjet prokurimeve publike, shpenzon përqindjen më të madhe nga Buxheti kombëtar. Ndaj, domosdoshmërisht ekziston nevoja për zbatim të mekanizmave ligjorë që demonstrojnë transparencë, konkurrencë, ekonomizëm dhe mosdiskriminim, si dhe mundësojnë realizim të vlerës më të mirë, gjatë prokurimit të mallrave, punëve dhe shërbimeve. Tema fiton rëndësi të shtuar për shkak të procesit të globalizimit, si dhe për shkak të tregut të brendshëm në territorin e Bashkimit Evropian, ku mundësohet edhe lëvizja e lirë e mallrave, kapitalit dhe shërbimeve, dukë qënë se Shqipëria është vend aspirant për të qënë anëtar i këtij Bashkimi.

## Parimet e prokurimit publik nën këndvështrimin e BE-së

**Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian:** Traktati nuk përfshin ndonjë dispozitë të veçantë në lidhje me prokurimin publik. Megjithatë, ai ka vendosur një numër parimesh themelore (parimet e Traktatit), në të cilat mbështetet BE-ja. Nga këto parime themelore, më të rëndësishmet për sa i përket publik prokurimi janë si më poshtë:

- Ndalimi i diskriminimit mbi bazën e kombësisë;
- Lëvizja e lirë e mallrave;
- Liria për të ofruar shërbime;
- Liria e vendosjes.

**Parimet e përgjithshme të së drejtës:** Përveç parimeve themelore të Traktatit, disa parime të përgjithshme të së drejtës kanë dalë nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJED). Këto parime të përgjithshme të së drejtës janë të rëndësishme për shkak se ato do të përdoret shpesh nga GJED-ja për të plotësuar boshllëqet në legjislacion dhe për të ofruar zgjidhje të situatave, të cilat shpesh janë shumë komplekse. Më të rëndësishmet nga këto parime të përgjithshme të ligjit në kontekstin e prokurimit janë si më poshtë:

- Barazia e trajtimit;
- Transparenca;
- Njohja reciproke;
- Proporcionaliteti.

Këto parime të përgjithshme zbatohen në mënyrë të pavarur nga Direktivat<sup>1</sup> përkatëse të prokurimit publik.

---

<sup>1</sup> European Commission, *Public Procurement - Current Legal Framework, Rules, Thresholds and Guidelines*, [https://ec.europa.eu/growth/single-market/public-procurement/legal-rules-and-implementation\\_en](https://ec.europa.eu/growth/single-market/public-procurement/legal-rules-and-implementation_en)





**Efektet ligjore të Direktivave:** Shtetet anëtare janë të detyruara të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që dalin nga Traktati ose që rezultojnë nga veprimet e ndërmarra nga institucionet e BE-së. Direktivat e listuara në footnote të ligjit shqiptar “Për prokurimin publik”, si të gjitha direktivat e tjera në këtë fushë, sipas përkufizimit, nuk janë drejtpërdrejt të zbatueshme, që do të thotë se ato nuk zbatohen automatikisht.

Në mënyrë që të prodhojnë efektet e tyre brenda shteteve anëtare, Direktivat duhet të zbatohen ose "transpozohen" në të drejtën kombëtare. Prandaj, Shtetet Anëtare duhet të marrin masat e nevojshme për t'i dhënë fuqinë e plotë dispozitive të Direktivave në të drejtën kombëtare dhe për të siguruar se nuk ka dispozita të tjera kombëtare që dëmtojnë zbatueshmërinë e dispozitive të direktivave. Këto masa zakonisht marrin formën e një transpozimi të Direktivave në të drejtën kombëtare dhe shfuqizimin e të gjitha dispozitive të kundërta ligjore. Direktivat janë detyruese vetëm në aspektin e rezultatit që duhet arritur, ndërkohë që, në përgjithësi, ia lënë autoriteteve kombëtare zgjedhjen e formës dhe të metodave. Nuk është e nevojshme që Shtetet Anëtare të BE-së të prodhojnë një kopje të saktë të Direktivave në legjislacionin e tyre kombëtar, edhe pse rezultoni se një shumicë e madhe e shteteve anëtare kanë bërë pikërisht këtë gjë.

**Parimet bazë të prokurimit publik:** Që në fillesat e tij, një nga objektivat kryesore të Bashkimit Evropian ka qenë për të krijuar një treg të përbashkët që eliminon pengesat për tregtinë e mallrave dhe shërbimeve midis shteteve anëtare të BE-së. Krijimi i një tregu të përbashkët të prokurimit nënkupton largimin e pengesave të tregtisë që rrjedhin nga konteksti i prokurimit. Një nga qëllimet kryesore të legjislacionit të prokurimit publik është për të eliminuar pengesat ekzistuese dhe për të parandaluar ngritjen e pengesave të reja. Këtë e bëjnë duke zbatuar parimet bazë që burojnë nga legjislacioni.

Ndonëse këto parime janë të ndërlidhura, ato mund të reduktohen në një numër parimesh themelore:

- **Konkurrenca:** Nga këndvështrimi ekonomik, "konkurrenca" vepron si një procedurë shpallje, duke lejuar operatorë të ndryshëm ekonomikë që të komunikojnë çmimet, me të cilat janë të disponueshme në treg mallrat dhe shërbimet. Këto çmime veprojnë si shenja udhëzuese dhe pasqyrojnë kushtet e kërkesës dhe ofertës në çdo moment të caktuar. Ato gjithashtu pasqyrojnë dallimet e cilësisë, të afateve dhe kushteve të shitjes së produkteve të ndryshme (jo-homogjene) të disponueshme. Kjo është arsyeja pse shpallja është aq e rëndësishme. Shpallja garanton publikimin dhe konkurrencën më të gjerë të mundshme, duke bërë të mundur që operatorët ekonomikë nga e gjithë BE-ja të marrin pjesë dhe të sigurojnë zgjedhjen më të madhe të mundshme.

- **Trajtimi i barabartë dhe mos-diskriminimi:** Konceptet e trajtimit të barabartë dhe të mosdiskriminimit nuk janë të njëjta. Në përgjithësi, i gjithë legjislacioni i prokurimit kërkon që të ruajë barazinë ndërmjet operatorëve ekonomikë. Megjithatë, në kontekstin e BE-së, barazia do të jetë e bazuar edhe tek "kombësia". Trajtimi i barabartë është një koncept që në përgjithësi kërkon që situatat identike të trajtohen në të njëjtën mënyrë apo që situatat e ndryshme nuk duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë, dhe kërkon trajtim të njëjtë për njerëzit e njëjtë. Në kontekstin e BE-së, koncepti i trajtimit të barabartë kërkon edhe një përkufizim,





pasi, në këtë kontekst koncepti i barazisë bazohet gjithashtu edhe tek kombësia ose origjina e mallit. Si rezultat, të gjithë operatorët ekonomikë me kombësi të BE-së dhe të gjitha ofertat, duke përfshirë edhe mallrat me origjinë të BE-së, duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë (ky është parimi i mosdiskriminimit).

• **Transparenca:** Transparenca u shfaq kohët e fundit si një parim, edhe pse është ndoshta më mirë ta mendojnë atë si një mjet që do të përdoret për të arritur objektivat e tjera.

Për shembull:

- Publikimi dhe aksesimi në legjislacion ofron qartësi dhe siguri për të gjitha palët e interesuara dhe u mundëson autoriteteve kontraktuese dhe operatorëve ekonomik që të jenë të vetëdijshëm për rregullat e lojës.
- Kërkesat e shpalljes garantojnë transparencë në procesin e publikimit.
- Publikimi paraprakisht i specifikimeve teknike dhe përzgjedhja e kriterëve u mundëson palëve të interesuara që t'i verifikojnë këto specifikime dhe kriterë, nëse janë apo jo, të drejta dhe jo diskriminuese.

Kërkesat e regjistrimit dhe të raportimit sigurojnë që veprimet e autoriteteve kontraktuese mund të verifikohen kur është e përshtatshme. Kërkesat e regjistrimit dhe të raportimit janë gjithashtu një aspekt themelor i "llogaridhënies", domethënë, i vënë zyrtarët e prokurimit para përgjegjësisë për vendimet dhe veprimet e tyre.

**"Llogaridhënia":** është gjithashtu shpesh një objektivi i qartë i sistemeve kombëtare të prokurimit, dhe dispozitat e transparencës e përforcojnë këtë llogaridhënie.

Disa nga parimet e mësipërme janë artikuluar në mënyrë të ndryshme ose janë kombinuar në legjislacionin kombëtar. Mund të gjenden të përcaktuara në legjislacion parimet e tilla, për shembull, si "ekonomia dhe efikasiteti", "vlera e parasë", dhe "ndershmëria" ose "integriteti".

Vlera e parasë: Një nxitës i rëndësishëm ekonomik në themel të proceseve të prokurimit është nevoja për të siguruar që e gjithë blerja paraqet vlerën e parasë. Direktivat nuk e trajtojnë në mënyrë specifike këtë çështje, por është e rëndësishme që të mos harrojmë nevojën për të garantuar se vlera për para do të jetë një nga rezultatet kryesore të procesit të prokurimit. Termi "vlera për para" nënkupton kombinimin optimal mes faktorëve të ndryshëm të lidhur dhe jo të lidhur me koston, që se bashku përmbushin kërkesat e autoritetit kontraktues. Elementet që përbëjnë kombinimin optimal të këtyre faktorëve të ndryshëm ndryshojnë nga prokurimi në prokurim dhe varen nga rezultatet e kërkuara nga autoriteti kontraktues, për ushtrimin e prokurimit në fjalë.





## Korniza ligjore e prokurimit publik deri në 31 mars 2021

Legjislacioni në fushën e prokurimit publik ishte i përbërë nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar<sup>2</sup>, si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Këto instrumente ligjore ishin bazuar në direktivën 2004/18/EC, “Për koordinimin e procedurave të prokurimit për dhënien e kontratave publike për punë, furnizime dhe shërbime” (direktiva e sektorit publik), direktivën 2004/17/EC, “Për koordinimin e procedurave të prokurimit të enteve që veprojnë në sektorin e shërbimit ujor, energjetik, të transportit dhe postar” (direktiva e utiliteteve), të cilat tashmë janë të shfuqizuara nga direktivat e reja të vitit 2014, si dhe në direktivën 2007/66/EC e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian, e datës 11 dhjetor 2007, që ndryshon direktivat 89/665/EC dhe 92/13/EC sa i takon rritjes së efektshmërisë për procedurat e shqyrtimit të kontratave publike.

Gjithashtu, legjislacioni në fushën e prokurimit publik përmban dy vendime të Këshillit të Ministrave, të cilat rregullojnë dhe më tej prokurimin e përqendruar në nivel qeverie, konkretisht VKM nr. 81<sup>3</sup>, datë 14.2.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara”, dhe VKM nr. 82<sup>4</sup>, datë 14.2.2018, “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”.

Si ndërveprues me fushën e prokurimit publik në Shqipëri është dhe fusha e koncesioneve dhe PPP-ve, e cila rregullohet nga ligji 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar<sup>5</sup>, i cili bazohet në direktivën 2014/23/BE për dhënien e kontratave të koncesionit. Ky ligj mbështetet edhe nga akte nënligjore, konkretisht: VKM nr. 280, datë 7.4.2020<sup>6</sup>, “Për miratimin e rregullores për mënyrën e funksionimit të komitetit të përzgjedhjes të projekteve të koncesionit/PPP dhe kriteret për vlerësimin e kërkesave të autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar”; VKM nr. 285, datë 10.4.2020, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve” (ATRAKO)<sup>7</sup>.

<sup>2</sup> Public Procurement Agency, Law no. 9643, dated 20.11.2006, "On public procurement", as amended, <https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=5a6fa8ae-6fec-48bc-bdf1-bc419c0b4734>

<sup>3</sup> Concentrated Purchasing Agency, no. 81 dated 14.2.2018, "On the establishment, organization and functioning of the Concentrated Purchasing Agency", <http://abp.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/VKM-nr.-81-date-14.2.2018.pdf>

<sup>4</sup> Public Procurement Agency, DCM no. 82, dated 14.2.2018, "On authorizing the Concentrated Purchasing Agency for conducting public procurement procedures in the name and on behalf of the Prime Minister's Office, ministries and subordinate institutions, for certain goods and services", <https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=b40d686d-8b11-4235-9237-d6a76106b204>

<sup>5</sup> Concession Treatment Agency, Law 125/2013, "On concessions and public private partnership", as amended, [http://atrako.gov.al/wp-content/uploads/2015/09/Ligji-Nr.125\\_2013-p%C3%ABrdit%C3%ABsuar.pdf](http://atrako.gov.al/wp-content/uploads/2015/09/Ligji-Nr.125_2013-p%C3%ABrdit%C3%ABsuar.pdf)

<sup>6</sup> Official Journal, DCM no.280, dated 7.4.2020 "On the approval of the regulation on the functioning of the selection committee for concession/PPP projects and the criteria for evaluating the requests of contracting authorities for support with specialized expertise", <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/04/07/280>

<sup>7</sup> Official Journal, DCM no.285, dated 10.4.2020 "On the organization and functioning of the Concession Treatment Agency", <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/04/10/285/5075cdd9-37f4-483b-8030-c3f04652f9b7>





Si pjesë e fushës së prokurimit publik është edhe prokurimi në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, e cila rregullohet nëpërmjet akteve nënligjore të miratuara me VKM apo udhëzime të nxjerra nga secili institucion, sipas fushës përkatëse, pa pasur rregulla të qarta dhe të unifikuara. Gjithsesi, me finalizimin e ligjit për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë dhe miratimin e tij nga Kuvendi në muajin prill 2020, këto lloj prokurimesh rregullohen nëpërmjet këtij ligji, i cili është hartuar në përputhje me direktivën 2009/81/EC për prokurimet në këtë fushë. Në mënyrë që ligji i ri të ishte plotësisht i zbatueshëm, është e nevojshme hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore përkatëse, për të cilat ishte parashikuar një periudhë tranzitore.

Institucionet përgjegjëse për këto fusha janë si më poshtë:

- Agjencia e Prokurimit Publik;
- Komisioni i Prokurimit Publik;
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (ATRAKO);
- Ministria e Mbrojtjes;
- Ministria e Brendshme;
- Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Agjencia e Prokurimit Publik (APP) është institucioni politikëbërës në fushën e prokurimit publik në Shqipëri dhe disa prej detyrave kryesore të saj janë propozimi i masave rregulluese, verifikimi i ligjshmërisë së sistemit të prokurimit publik, përgatitja e dokumenteve standarde të tenderit, asistimi dhe hartimi i programeve për ngritjen e kapaciteteve në fushën e prokurimit publik, si dhe përjashtim i operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik. APP-ja është institucion buxhetor dhe është nën varësi të Këshillit të Ministrave. Fushëveprimi i saj përcaktohej qartazi në nenin 13, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar<sup>8</sup>.

Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) është organi më i lartë administrativ për shqyrtimin e ankesave në fushën e prokurimeve. KPP-ja është institucion i pavarur, anëtarët e të cilit zgjidhen nga Parlamenti, në vijim të një procedure përzgjedhëse të zhvilluar nga Këshilli i Ministrave dhe raporton para Parlamentit. KPP-ja shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, procedurat konkurruese për koncesionet dhe PPP-të dhe lejet minerare.

Agjencia për Trajtimin e Koncesioneve (ATRAKO) është një institucion në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe ndër detyrat kryesore të saj është dhënia e asistencës për Autoritetet Kontraktore në projektet koncesionare dhe partneritetet publike-private, si dhe në zhvillimin e procedurave, dhënien e asistencës në hartimin dhe unifikimin e dokumenteve standarde të tenderit për procedurat koncesionare/PPP dhe organizimin e trajnimeve për stafin, që zbaton projektet e koncesionit/PPP. Kompetencat e ATRAKO-s janë të përcaktuara në ligjin 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar<sup>9</sup>.

<sup>8</sup>Public Procurement Agency, Law no. 9643, dated 20.11.2006, "On public procurement", as amended, <https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=5a6fa8ae-6fec-48bc-bdf1-bc419c0b4734>

<sup>9</sup>Public Procurement Agency, Law no. 9643, dated 20.11.2006, "On public procurement", as amended, <https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=5a6fa8ae-6fec-48bc-bdf1-bc419c0b4734>





Agjencia e Blerjeve të Përqendruara është një institucion buxhetor në varësi të Ministrisë së Brendshme dhe funksionon si organ qendror blerës për Kryeministrinë, ministrinë e linjës dhe institucionet e varësisë. Agjencia i ushtron kompetencat e saj bazuar në VKM-në nr. 81, datë 14.2.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara”, dhe VKM-në nr. 82, datë 14.2.2018, “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë, për disa mallra dhe shërbime”.

Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme janë institucionet kryesore përgjegjëse për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë.

### Raporti i Komisionit European për Shqipërinë 2019<sup>10</sup>:

Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar lidhur me prokurimin publik. Është bërë progres gjatë vitit të kaluar, në veçanti përmes ndryshimit të ligjit për koncesionet dhe partneritetit publik privat (PPP), për të hequr përfitimet në këmbim të propozimeve të pakërkua në përputhje me rekomandimet e Komisionit dhe të ligjit të ri të miratuar për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar pajtueshmërinë me procedurat dhe për të parandaluar korrupsionin në ciklin e prokurimit. Rekomandimet e Komisionit nga viti 2019 nuk janë zbatuar plotësisht dhe mbeten ende të vlefshme.

Vitin e ardhshëm Shqipëria duhet, në veçanti:

- të miratojë ligjin e ri të planifikuar për prokurimin publik dhe ligjin për prokurimet për mbrojtjen, në mënyrë që të harmonizojë më tej kuadrin ligjor me direktivat e BE-së;
- të miratojë strategjinë e përgatitur të prokurimit publik në përputhje me strategjinë gjithëpërfshirëse të menaxhimit të financave publike;
- të sigurojë kapacitetet e nevojshme administrative në autoritetet kontraktuese dhe institucionin e kontrollit të lartë.

### Raporti i Komisionit European për Shqipërinë 2018<sup>11</sup>:

Shqipëria ka një nivel përgatitjeje në prokurimet publike. Duhet përpjekje për të përmirësuar respektimin e procedurave dhe parandalimin e korrupsionit në ciklin e prokurimit. Pak përparim është bërë vitin e kaluar për të harmonizuar më tej me *acquis* për forcimin e sistemit të rishikimit të prokurimit publik.

Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti:

- të transpozojë plotësisht direktivat e vitit 2014 për prokurimin publik të BE-së, përfshirë fushën e shërbimeve, koncesionet dhe prokurimet e mbrojtjes;
- të forcojë më tej kapacitetet administrative të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të autoriteteve kontraktore;
- të ndjekë në mënyrë sistematike konfliktet e interesit dhe forcojnë kapacitetet e auditimit të shtetit në këtë aspekt.

<sup>10</sup> European Commission, *Albania Country Report 2019*, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2019-07/20190529-albania-report.pdf>

<sup>11</sup> European Commission, *Albania Country Report 2018*, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/20180417-albania-report.pdf>







## Ligji i ri nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, hyrë në fuqi në 31 mars 2021

Nevoja për hartimin e këtij ligji erdhi si rezultat i domosdoshmërisë së rregullimit të kuadrit legjislativ për prokurimin publik, nisur nga rekomandimet e ndryshme të organizmave ndërkombëtarë, si: Komisioni Evropian, Banka Botërore, OECD/SIGMA, rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, si rezultat i problematikave të ndryshme të hasura në praktikë gjatë procesit të prokurimit apo edhe kërkesave për ndryshime nga institucione të ndryshme, sipas fushave respektive të kompetencës.

Ligji i ri “Për prokurimin publik”<sup>12</sup> sjell risi në disa drejtime, si:

- Qartësim i fushës së zbatimit të ligjit, përjashtimet specifike dhe kontrata të përziera të prokurimit;
- Parashikimi, për herë të parë, i konceptit të kontratave të rezervuara dhe kontratave ndërmjet subjekteve brenda sektorit publik;
- Parashikimi i njoftimeve paraprake dhe periodike të informacionit, si mjete që rrisin transparencën, dhe i japin mundësi operatorëve ekonomikë të njihen kohë më parë me të dhënat e një objekti konkret prokurimi të planifikuar;
- Ligji përcakton kufij të ulët dhe të lartë monetar, ku për të gjitha procedurat mbi kufirin e lartë monetar ruhen parashikimet e direktivës, ndërkohë që parashikohen afate më të shkurtuara për procedurat nën këtë kufij, pra për procedurat kombëtare;
- Parashikimi i procedurave të prokurimit, sipas direktivave përkatëse të BE-së, duke parashikuar procedura të reja prokurimi, me faza, siç janë: procedura konkurruese me negociim, dialogu konkurrues dhe partneriteti për inovacion;
- Procedura më të thjeshtuara në prokurimin e veprimtarive të sektorit sektorial. Projektligji trajton në tërësinë e tij, si prokurimin e sektorit klasik, ashtu edhe atij sektorial, me përcaktime në nenet që vlejnë për të dy sektorët, si dhe një kapitull të posaçëm, me rregullime specifike për sektorin sektorial (i cili, përfshin veprimtari që kanë të bëjnë me shërbimet e transportit, ujit, energjisë, gazit, shërbimet postare, portet dhe aeroportet);
- Lehtësimi i pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nëpërmjet përdorimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta;
- Parashikimi i përdorimit të kriterit për vlerësim “oferta ekonomikisht më e favorshme”, e cila identifikohet në bazë të çmimit dhe koston, duke përdorur metodën e efektivitetit të koston;
- Paraqitja e sigurimit të ofertës, si një masë mbrojtëse për autoritetet kontraktore, në rast të tërheqjes së ofertuesit;

<sup>12</sup>The Parliament, Law 162/2020 “On Public Procurement”,

<https://www.parlament.al/Files/Akte/20210107122902ligji%20nr.%20162%20dt.%2023.12.2020.pdf>





- Në referim të parashikimeve në direktivë, Ligji njih për herë të parë konceptin e reduktimit të numrit të operatorëve ekonomikë, të kualifikuar në procedurat me faza, nëse një gjë e tillë përcaktohet si mundësi nga autoriteti kontraktor që në dokumentet e tenderit;
- Ulja e afatit minimal të periudhës së përjashtimit të operatorëve ekonomikë nga e drejta për të fituar kontrata publike, duke filluar nga 3 muaj;
- Parashikimi i periudhës së pritjes, gjatë së cilës autoriteti kontraktor nuk mund të nënshkruajë kontratë, periudhë e cila fillon nga shpallja e njoftimit të fituesit;
- Lehtësi në prokurimin e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera të veçanta, të cilat i nënshtrohen një regjimi të posacëm, të thjeshtuar prokurimi;
- Rritja e rolit kontrollues të APP-së në drejtim të verifikimit të zbatimit të ligjshmërisë në procedurat e prokurimit, përfshi ato të anuluar, dhe monitorimit të zbatimit të kontratave;
- Ankimi i operatorëve ekonomikë, njëkohësisht si në autoritetin kontraktor, edhe në Komisionin e Prokurimit Publik, duke shkurtuar procesin e rishikimit administrativ i afateve të ankimit;
- Parashikimi për herë të parë i konceptit të modifikimit të kontratave, si dhe rasteve të pavlefshmërisë së kontratave.<sup>13</sup>

#### **Raporti i Komisionit European për Shqipërinë, date 19.10.2021<sup>14</sup>:**

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në prokurimet publike. Është bërë përparim i mirë, veçanërisht duke miratuar ligjin e ri për prokurimin publik dhe strategjinë e prokurimit publik, pas konsultimeve të gjera publike. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar përputhshmërinë me procedurat dhe për të parandaluar korrupsionin në ciklin e prokurimit. Rekomandimet e Komisionit nga viti 2020 u zbatuan kryesisht. Rekomandimi për kapacitetet adekuat administrativ është reflektuar në strategjinë e prokurimit publik 2020-2023 dhe tani kërkon ndjekje.

Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet të:

- të miratojë legjislacionin e mbetur për zbatimin e ligjit të ri të prokurimit publik;
- të zhvillojë dhe zbatojë sistemin elektronik të menaxhimit të kontratave dhe regjistrin elektronik të ankesave për përmirësimin e monitorimit dhe transparencës;
- të sigurojë që kushtet e marrëveshjeve ndërqeveritare, të lidhura me vendet e treta, të jenë në përputhje me kërkesat e *acquis* të përfshira në MSA, veçanërisht në fushën e prokurimit publik.

Tregu i prokurimeve publike të Shqipërisë përfaqësoje rreth 9.4% të PBB-së në 2020 krahasuar me 4.8% në 2019. Rritja është nxitur kryesisht nga rindërtimi pas tërmetit dhe një rënie e PBB-së, për shkak të ndikimit ekonomik të COVID-19. Në vitin 2020, numri mesatar

<sup>13</sup>Albanian Parliament, *Assessment Report on the draft-law "On Public Procurement"*,

<https://parlament.al/Files/ProjektLigje/20200907142101RELACION%20-%20PROKURIMI%20PUBLIK.pdf>

<sup>14</sup> European Commission, *Albania Country Report 2021*, [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en)





i ofertave për tender ishte 2.57 krahasuar me 2.37 në 2019 dhe 3.05 në 2018. Planifikimi dhe përgatitja e procedurave të prokurimit publik janë përgjithësisht transparente, dhe parimet efikase dhe parashikimet e prokurimit publik publikohen rregullisht. Ligji i ri i prokurimit publik, në përputhje me direktivat e BE-së, parashikon përdorimin e tenderit ekonomikisht më të favorshëm. Megjithatë, regjimi i thjeshtuar i prokurimit për shërbimet sociale dhe procedura e partneritetit të inovacionit ende kërkojnë miratimin e rregulloreve, si dhe ngritjen e kapaciteteve në autoritetet kontraktore. Të gjitha instrumentet ligjore dhe financiare të përdorura në fushën e prokurimeve publike dhe koncesioneve, duke përfshirë marrëveshjet ndërqeveritare të lidhura me vendet e treta për zbatimin e projekteve të përbashkëta, duhet të jenë në përputhje me parimet e transparencës, konkurrencës, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit. Në monitorimin e lidhjes dhe zbatimit të kontratës, pas monitorimit nga afër nga APP, numri i procedurave të negociuara pa publikim paraprak ka vijuar të bjerë në vitin 2020, pa marrë parasysh COVID-19 dhe rindërtimin (në 151, nga 192 në 2019 dhe 531 në 2018). Në vitin 2020, numri i procedurave të prokurimit me negociim “pa publikim paraprak” në lidhje me COVID-19 dhe rindërtimin pas tërmetit arriti në 191 dhe 74, përkatësisht, duke zënë përkatësisht 1,45% dhe 1,47% të vlerës së të gjitha prokurimeve në atë periudhë. Përdorimi i marrëveshjeve kuader mbeti i lartë në numër (677 në 2020, krahasuar me 763 në 2019 dhe 627 në 2018) me rritje të mëtejshme të vlerës së prokuruar përmes marrëveshjeve kornizë (rreth 216 milionë euro në 2020, krahasuar me rreth 166 milionë euro në 2019 dhe rreth 86 milionë euro në 2018).

Shqipëria ka një portal qendror elektronik të prokurimeve publike, ku publikon njoftimet e tenderëve dhe kontratave, si dhe informacione dhe udhëzime të tjera të rëndësishme. Përdorimi i portalit është i detyrueshëm, duke përfshirë edhe prokurimin me vlerë të lartë. Dokumentet standarde të tenderit për çdo lloj procedure dhe kontratë publikohen në faqen e APP-së, dhe regjistri i parashikimit të prokurimit përgatitet dhe postohet online.<sup>15</sup>

---

<sup>15</sup> Ibid.



## DISA KONKLUSIONE DHE SFIDA

### I.

#### Harmonizimi dhe bashkëpunimi

Prokurimi Publik është një fushë dinamike, që ndryshon dhe evoluon në mënyrë të vazhdueshme si pasojë edhe e ndryshimeve të klimës së tregtisë dhe biznesit, si dhe të zhvillimeve e përmirësimeve të teknologjisë. Nga ana tjetër, prokurimi publik ka një natyrë ndërsektoriale, duke qenë ngushtësisht i lidhur në mënyrë reciproke me fusha të tjera të rëndësishme, si: lufta kundër korrupsionit, konkurrenca e lirë dhe e ndershme, mbrojtja e shëndetit dhe konsumatorit, mbrojtja e mjedisit, klima e biznesit dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME), zhvillimi i qendrueshëm etj.

Është e qartë se të pasurit e ligjeve të mira për financimin e partive politike, standarde të larta etike në shërbimin civil, përqëndrim të ulët të furnizuesve, një nivel të kënaqshëm të burimeve dhe ekspertizës teknike, si dhe informacion transparent mbi organet kontrolluese të nënpunësve civil apo zyrtarëve të zgjedhur, të ngarkuar me prokurimin publik, e ligje më të forta anti-korrupsion do të kontribuonin në procedurë dhe në rezultate sipas kërkesavë të Bashkimit Europian dhe reduktimin e peshës së korrupsionit në prokurimet publike. Është me vlerë të përmendet se zbatimi i ligjeve anti-korrupsion apo të konkurrencës (zakonisht të besuara tek autoriteti konkurrues) është plotësisht e pavarur nga zbatimi i ligjeve kundër korrupsion (zakonisht të besuara tek organet antikorrupsion dhe gjyqësore). Shkëmbimi sistematik i informacionit midis agjensive zbatuese dhe investigimet e përbashkëta janë shumë të rekomanduara. Në veçanti, do të dukej me vend të hapej sistematikisht një investigim konkurrues mbi tregjet e prokurimit, për të cilat janë gjetur prova korrupsioni.

Nga ana tjetër, duhet të zhvillohet një përpjekje e shtuar që të harmonizohet më mirë dhe të garantohet zbatimi në praktikë i përcaktimeve të ligjeve të tjera, në raport me fushën e prokurimeve publike. Përshembull, sipas Neni 92/1 të Kodit Zgjedhor, paragrafi i katërt, përcakton se *“4. Personat fizikë ose personat juridikë, që i kanë bërë dhurime një subjekti zgjedhor apo kandidatëve të tij në zgjedhje, nuk mund të përfitojnë për periudhën deri 3 vjet pas datës së zgjedhjeve kontrata publike, kontrata të partneritetit publik privat ose në çdo mënyrë tjetër fonde me vlerën totale që tejkalon shumën prej 10 milionë lekësh, përfshirë edhe si nënkontraktues të një kontrate/koncesioni publik.”*

Ndërsa pikat e tjera të nenit 92/1 të Kodit Zgjedhor përcaktojnë kritere ndaluese për një financues të subjekteve zgjedhore, verifikimi i të cilave i përket drejtpërdrejt KQZ-së, të paktën nga formulimet përkatëse të ligjit *“Për prokurimin publik”* dhe të Kodit Zgjedhor nuk rezulton se si duhet të zbatohet ky përcaktim ligjor në periudhat postzgjedhore nga autoritetet prokuruese dhe institucionet e tjera qendrore të prokurimit publik.



## II. Strategjia e prokurimit publik<sup>16</sup>

Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 850, datë 4.11.2020 ka vendosur miratimin “*Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Prokurimin Publik 2020-2023 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj*”.

Në këtë strategji theksohet se qëllimi i një prokurimi efektiv është që të sigurojë mallra dhe shërbime me çmimet më të ulëta dhe cilësinë më të mirë. Në këtë kuptim, objektivat kryesore, mbi të cilat duhet të mbështetet veprimtaria e institucioneve shqiptare 2020 - 2023 janë si më poshtë:

- Rritja e transparencës;
- Përmirësimi i efikasitetit në përdorimin e fondeve publike;
- Përmirësimi i planifikimit të prokurimit publik;
- Përmirësimi i menaxhimit të kontratave;
- Përmirësimi i kuadrit institucional përgjegjës për prokurimin publik;
- Përmirësimi i sistemit të prokurimit të përqendruar;
- Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional për shqyrtimin e ankesave;
- Profesionalizimi i funksionit të prokurimit publik;
- Përmirësimi i kuadrit ligjor;
- Përmirësimi i sistemit elektronik të prokurimit;
- Garantimi i procedurave të qendrueshme të prokurimit publik në respektim të mirëqenies sociale, mbrojtjes së mjedisit, etj.;
- Rritja e pjesëmarrjes së SME-ve në procedurat e prokurimit publik.

Për komponentët e mësipërm kërkohet zbatimi në kohë i të gjithë objektivave të përcaktuara, në përputhje me planin e veprimit.

## III. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 29 datë 02.07.2021<sup>17</sup>

Në datën 05.07.2018, Kuvendi, me propozim të Këshillit të Ministrave, ka miratuar ligjin nr. 37/2018<sup>18</sup> “*Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar*”. Ligji i është dërguar Presidentit për dekretim.

<sup>16</sup> Public Procurement Agency, *Public Procurement Strategy 2020-2023*, <https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=4b54d140-e98b-434b-abfb-d3966453b8dd>

<sup>17</sup> Constitutional Court, *Final Decisions*, Decision no.29 dated 02.07.2021 [https://www.gjk.gov.al/web/Vendime\\_perfundimtare\\_100\\_1.php](https://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php)

<sup>18</sup> The Parliament, Law no. 37/2018 “*On determining a special procedure for negotiating and signing a contract for the “Design and implementation of the urban project and the new building of the National Theater*” <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20180926123505ligj%20nr.%2037.%20dt.%2020.9.2018%20I%20rishikuar.%20i%20rivotuar.pdf>





Presidenti, me dekretin nr. 10849<sup>19</sup>, datë 27.07.2018, ka vendosur të kthejë ligjin nr. 37/2018 për rishqyrtim në Kuvend, duke arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, se ai cënon parimin e barazisë përpara ligjit dhe lirinë e veprimtarisë ekonomike, identitetin dhe trashëgiminë kombëtare, parimin e decentralizimit dhe të autonomisë vendore.

Kuvendi, në seancën plenare të datës 20.09.2018, pasi ka miratuar dekretin për rishqyrtimin e ligjit, ka miratuar ligjin nr.37/2018, datë 20.09.2018 “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt “Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar” (ligji nr. 37/2018).

Presidenti ka vendosur ta kthejë përsëri për rishqyrtim në Kuvend ligjin nr.37/2018, duke parashtruar se të gjitha argumentet që shoqëronin dekretin e tij të mëparshëm nuk ishin shqyrtuar objektivisht nga Kuvendi dhe konstatimet për antikushtetutshmërinë e këtij ligji mbeteshin të njëjta, si në ligjin e mëparshëm.

Kuvendi, në seancën plenare të datës 25.10.2018, ka vendosur të rrëzojë dekretin nr.10908<sup>20</sup>, datë 11.10.2018 të Presidentit për rishqyrtimin e ligjit nr.37/2018.

Gjykata në jurisprudencën e saj e ka interpretuar gjerësisht konceptin e lirisë së veprimtarisë ekonomike. Sipas saj, kjo liri nënkupton kryesisht të drejtën për të lidhur kontrata, individualisht ose kolektivisht, lirisht dhe mbi bazën e vullnetit personal, të drejtën për të zgjedhur aktivitetin që dëshiron të ushtrojë individi, të drejtën për të zgjedhur një punë sipas preferencës, etj. Kjo liri përfshin të gjitha të drejtat që lidhen me prodhimin, shpërndarjen ose konsumin e mallrave dhe të shërbimeve.

Gjithashtu, GJED-ja është shprehur se, nëse një masë e ndërmarrë nga shteti passjell pabarazi mundësisht midis operatorëve ekonomikë dhe, për rrjedhojë, shtrembëron konkurrencën, atëherë, një masë e tillë përbën një shkelje të ligjit të BE-së për konkurrencën (C-462/99, *Connect Austria Gesellschaft für Telekommunikation GmbH kundër Telekom-Control-Kommission*, 22 maj 2003, § 84)<sup>21</sup>. Edhe kur objekt i shqyrtimit kanë qenë prokurimet publike, GJED-ja ka arritur në përfundimin se, sipas parimit të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, qëllimi i të cilit është të promovojë zhvillimin e një konkurrence të shëndetshme dhe efektive midis operatorëve që marrin pjesë në një procedurë prokurimi publik, këtyre të fundit duhet t'u jepen mundësi të barabarta në formulimin e ofertave të tyre, çka nënkupton që operatorët duhet t'i nënshtrohen të njëjtave kushteve. Për më tepër, parimi i trajtimit të barabartë do të thotë që ofertuesit duhet të jenë në gjendje të barabartë, si gjatë fazës së përgatitjes së prokurimeve të tyre, ashtu edhe kur ofertat vlerësohen nga autoriteti kontraktues. Në të gjitha procedurat e prokurimit, autoriteti kontraktues duhet të përcaktojë dhe verifikojë nëse ekzistojnë rreziqe reale që të rezultojnë në shtrembërimin e konkurrencës

<sup>19</sup> The Parliament, Presidential Decree No. 10849, dated 27.07.2018 on the review of law no. 37/2018, <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20180903113228dekret%2010849.pdf>

<sup>20</sup> The Parliament, Presidential Decree No. 10908 on the review of law no. 37/2018, <https://www.parlament.al/Files/LigjeRishqyrtim/Dekreti%20nr%20%2010908.pdf>

<sup>21</sup> The Court of Justice of the European Union, C-462/99, *Connect Austria Gesellschaft für Telekommunikation GmbH v. Telekom-Control-Kommission*, 22 May 2003, § 84, <https://curia.europa.eu/juris/showPdf.jsf?text=&docid=102229&pageIndex=0&doclang=en&mode=req&dir=&occ=first&part=1&cid=7447426>





*(T-292/15, Vakakis kai Synergates — Symvouloi gia Agrotiki Anaptixi AE Meleton kundër European Commission, 12 shkurt 2019, §§ 97 dhe 100).*

Nga provat e administruara gjatë gjykimit, konstatohet se Komisioni Evropian në lidhje me ligjin nr. 37/2018 shprehet: *“Për sa i përket konkurrencës dhe ndihmës shtetërore, ky ligj vetëm përcakton procedurën për vlerësimin dhe negocimin e kontratës me shoqërinë e përzgjedhur (...) Edhe pse në këtë fazë nuk konstatohet asnjë shkelje e MSA-së, shërbimet e komisionit vazhdojnë të inkurajojnë autoritetet shqiptare të ndjekin përputhshmërinë me parimet e prokurimit publik të BE-së dhe të garantojnë akses jodiskriminues në treg. Në lidhje me këtë shërbimet e Komisionit përshëndesin angazhimin e autoriteteve shqiptare për të amenduar ligjin, me synimin për të paraqitur një thirrje të hapur për zbatimin e projektit të zhvillimit të Teatrit Kombëtar, ku çdo palë private mund të paraqesë propozim për projektin.”*

Gjykata konstatoi se ligji nr.37/2018 i miratuar në datën 05.07.2018, në pikën 8 të nenit 1, parashikonte se kontrata ndërmjet pronarit-shtet dhe partnerit privat duhet të përmbajë propozimin e paraqitur nga shoqëria “F” sh.p.k. Ndërkohë, ligji nr. 37/2018 i miratuar në datën 20.09.2018, pas rishqyrtimit të tij nga Kuvendi, në pikën 1 të nenit 8, parashikonte që kontrata ndërmjet pronarit-shtet dhe palës private të përzgjedhur duhet të përmbajë propozimin e paraqitur nga ky i fundit, duke mos përmendur asnjë subjekt privat nominalisht ose të paracaktuar për realizimin e projektit.

Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se shtimi i kriterëve nga ana e ligjvënësit, me qëllim ushtrimin e një veprimtarie të caktuar, është brenda hapësirës së tij të veprimit dhe vlerësimit. Është e drejtë e ligjvënësit të vlerësojë, rast pas rasti, nevojën e ndërhyrjes me anë të një rregullimi të ri. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se, pavarësisht diskrecionit që ka ligjvënësi për të vepruar brenda hapësirës së tij normuese, duke përcaktuar qartë dhe rast pas rasti qëllimet që kërkon të arrijë, është e papranueshme në shtetin e së drejtës ndërmarrja dhe miratimi i nismave ligjvënëse të pabazuara në vlerësime ose studime paraprake.

Në rastin në shqyrtim nuk rezulton që të jenë kryer vlerësime të plota dhe të argumentura për mënyrën e shkëmbimit të pronës shtetërore edhe në lidhje me vlerësimin ekonomik të saj. Për më tepër, Gjykata vlerëson se kriteri i parashikuar në pikën 3 të nenit 6 të ligjit nr. 37/2018 bën trajtim favorizues për shoqërinë, e cila zotëron një pjesë të pronave në zonën ku do të zhvillohet projekti, përfshirë atë të ndërtimit të godinës së re të Teatrit Kombëtar, në raport me subjektet e tjera private, të cilat mund të kishin shprehur interes për të konkurruar për të realizuar këtë projekt zhvillimi. Ky kriter, jo vetëm është dekurajues për shoqëritë e tjera private, por edhe është i pamundur për t’u përmbushur prej tyre, duke qenë se ato vihen para kushtit për të arritur një marrëveshje pikërisht me vetë shoqërinë “Fusha” sh.p.k. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky kufizim nuk i përgjigjet kriterit të proporcionalitetit.



#### IV.

### **Akti Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”<sup>22</sup>**

Me Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, Këshilli i Ministrave ka miratuar rregullat për funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse. Objekti i këtij Akti Normativ është përballimi i pasojave të fatkeqësive natyrore që ndodhin në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të fatkeqësive të tjera që, për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile dhe të autoriteteve të tjera shtetërore dhe për të cilat shpallet gjendja e fatkeqësisë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile. Ky Akt Normativ ka përcaktuar edhe procedurat e prokurimit, që do të zbatohen në rastet e përballimit të pasojave të fatkeqësive natyrore.

Akti normativ me fuqinë e ligjit është bërë objekt ankimimi<sup>23</sup> në Gjykatën Kushtetuese. Organi AIS ka kërkuar shfuqizim të këtij Akti me Fuqi Ligjore me një Kërkesë Padi Depozituar në Gjykatën Kushtetuese në datën 28 Shtator 2021. Akti me fuqi Ligji në objektin e tij, për aspektin që rregullon procedurën e prokurimit publik, dështon në respektimin e këtyre parimeve themelore në fushën e prokurimit publik dhe që janë pjesë thelbësore e lirisë ekonomike dhe barazisë që mbrohen nga Kushtetua e Republikës së Shqipërisë.

Sikundër parashikohet në Aneksin 1, akti normativ me fuqinë e ligjit, për shkak të deformimeve të mëdha procedurale që përmban, dështon të sigurojë trajtimin e barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si dhe vlerën në para, integritetin, besimin publik dhe transparencën.

Në prokurimin publik, synimi është që të përfshihen dhe të marrin pjesë sa më shumë ofertues sa i përket tenderëve të paraqitur. Qëllimi i këtij parimi është që sa më shumë ofertues të kemi, ne si autoritet kontraktues do marrim cilësi më të mirë sa i përket produkteve dhe shërbimeve madje me kosto më të ulët. Andaj tendenca është që gjithmonë e më shumë në mesin e furnizuesve duhet të inkurajohen dhe motivohen në mënyrën më efikase dhe efektive të mundshme.

---

<sup>22</sup>Minister of State of Reconstruction, Normative Act no. 9, dated 16.12.2019 "On coping with the consequences of natural disasters", <https://rindertimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/02/akt-normativ-2019-12-16-9-Per-perballimin-e-pasojave-te-fatkeqesise-natyrore.pdf>

<sup>23</sup> Albanian Institute of Science, *Repeal of Chapter VI, PUBLIC PROCUREMENT PROCEDURES, articles 40 - 44, and article 4, point 7 and point 9, of the normative act with the force of law no. 9, dated 16.12.2019 "On coping with the consequences of natural disasters", approved by the Assembly of Albania with law no. 97/2019, on 18.12.2019*, [https://ndiqparate.al/wp-content/uploads/2021/09/AIS-Gjykatën-Kushtetuese\\_bilingual-2.pdf](https://ndiqparate.al/wp-content/uploads/2021/09/AIS-Gjykatën-Kushtetuese_bilingual-2.pdf)







Është e pashpjegueshme gjithashtu se, në kushtet kur “*de jure*” dhe “*de facto*” Shqipëria është në një situatë normale dhe pa asnjë kufizim të gjendjes së jashtëzakonshme, të vijojë të qëndrojë në fuqi akti normativ me fuqinë e ligjit objekt ankimi me dispozita dhe procedura të vecanta prokurimi. Ligji nr.162/2020 “*Për prokurimin publik*”, hyrë në fuqi në 31 mars 2021, si ligj organik që rregullon në mënyrë tërësore fushën e prokurimeve publike, është i hartuar sipas direktivave të legjisacionit të BE-së në fushën e prokurimit, ndaj edhe i jep zgjidhje cdo situatë, qoftë emergjente, qoftë normale, në të cilën gjenden autoritet kontraktore. Nuk ka asnjë arsye të logjikshme që të përlligjë bashkëekzistencën e aktit normative me fuqinë e ligjit për procedurën e prokurimit më ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

Si blerësi më i madh i mallrave dhe shërbimeve në vend, pushteti ekzekutiv është i vendosur në pozitën më unike për të promovuar dhe avancuar konkurrencën në mënyrë që të krijojë një ekonomi të fuqishme nga një perspektivë tregtare, si dhe një ekonomi që nxit pjesëmarrjen e plotë dhe të lirë nga të gjithë ata që dëshirojnë për të marrë pjesë. Prandaj, cdo akt normativ që prek prokurimin publik duhet të kërkojë të arrijë konkurrencën në aspektin e kësaj perspektive të dyfishtë. Natyra tregtare e konkurrencës nënkupton që një gamë të gjerë të furnitorëve duhet t'u jepet mundësi për të bërë oferta për prokurime, dhe autoriteti shtetëror duhet të zgjedhë më pas kontraktorin, oferta e të cilit përfaqëson opsionin më të mirë vlera për para.

Në Shqipëri në fushën e prokurimeve vërehet një dukuri specifike. Në përpjestim të drejtë, sa më shumë përmirësohet baza ligjore e prokurimit publik, aq më shumë rritet numri i procedurave speciale që anashkalojnë këto përcaktime të prokurimit, si me ligje të vecanta ashtu edhe me vendime të Këshillit të Ministrave. Ligji “*Për prokurimin publik*” është një ligj i vlerësuar nga aktorët vendas, aktorët ndërkombëtarë dhe vetë organizmat e Bashkimit Europian si një ligj i mirë në përputhje me standartet më të mira në këtë fushë. Për pasojë sfida mbetet implementimi korrekt i tij.

Duke qënë ligj tërësor prokurimi, në tekstin e tij parashikohet dhe gjen zgjidhje ligjore cdo situatë konkrete në të cilën mund të gjendet autoriteti publik, ndaj edhe miratimi dhe zbatimi i procedurave të vecanta *ad hoc* jashtë përcaktimeve të këtij ligji, përbën një pengesë serioze në rrugën e integritimit evropian.



## V. Përfundime

Prokurimi Publik është një fushë dinamike që ndryshon dhe evoluon në mënyrë të vazhdueshme si pasojë edhe e ndryshimeve të klimës së tregtisë dhe biznesit, si dhe të zhvillimeve e përmirësimeve të teknologjisë. Prokurimi ka një natyrë ndërsektoriale është ngushtësisht i lidhur në mënyrë reciproke me fusha të tjera të rëndësishme, si: lufta kundër korrupsionit, konkurrenca e lirë dhe e ndershme, mbrojtja e shëndetit dhe konsumatorit, mbrojtja e mjedisit, klima e biznesit dhe zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME), zhvillimi i qëndrueshëm etj.

Është e qartë se të pasurit e ligjeve të mira për financimin e partive politike, standarde të larta etike në shërbimin civil, përqendrim të ulët të furnizuesve, një nivel të kënaqshëm të burimeve dhe ekspertizës teknike si dhe informacion transparent mbi organet kontrolluese të nëpunësve civil apo zyrtarëve të zgjedhur të ngarkuar me prokurimin publik, ligje më të forta anti- korrupsion do të kontribuonin në prokurime publike në procedurë dhe në rezultate sipas kërkesave të Bashkimit Europian dhe reduktimin e përhapjes së korrupsionit në prokurimet publike.

Në funksion të arritjes së këtij qëllimi:

- Është me vlerë të përmendet se zbatimi i ligjeve anti-korrupsion apo të konkurrencës nga organet Administrative nuk duhet të jetë i pavarur nga zbatimi i ligjeve kundër korrupsion nga Agjencitë Ligjzbatuese (zakonisht të besuara tek organet antikorrupsion dhe gjyqësore). Shkëmbimi sistematik i informacionit midis agjencive zbatuese dhe investigimet e përbashkëta janë masa shumë të rekomanduara në realitetin shqiptar. Në veçanti duket me vend të hapet sistematikisht një investigim konkurrues mbi tregjet e prokurimit për të cilat janë gjetur prova korrupsioni.

- Duhet të harmonizojmë më mirë zbatimin e ligjeve të ndryshme në Shqipëri që rregullojnë të njëjtën temë, siç edhe u ilustrua me rastin e mangësive në përcaktimet e nenit 92/1 të Kodit. Qëllimi duhet të jetë shmangia e krijimit të xhepave ligjor, që inkurajojnë abuzimet në këtë aspekt.

- Duhet të shmangim ndryshimet e shpeshta në legjislacionin për prokurimet frekuenca e ndryshimeve të ligjit. Ky është një mësim i së kaluarës. Pavarësisht se ka shumë skeptikë për këtë gjë, ndryshimet e shpeshta duhet të eliminohen dhe të gjithë procesit të ligjvënës duhet t'i sigurohet transparenca dhe gjithëpërfshirja.

- Në Shqipëri në fushën e prokurimeve vërehet një dukuri specifike. Në përpjesëtim të drejtë, sa më shumë përmirësohet baza ligjore e prokurimit publik, aq më shumë rritet numri i procedurave speciale që anashkalojnë këto përcaktime të prokurimit, si me ligje të veçanta ashtu



edhe me vendime të Këshillit të Ministrave. Ligji "Për prokurimin publik" është një ligj i vlerësuar nga aktorët vendas, aktorët ndërkombëtarë dhe vetë organizmat e Bashkimit Europian si një ligj i mirë në përputhje me standardet më të mira në këtë fushë.

Duke qenë ligj tërësor prokurimi, në tekstin e tij parashikohet dhe gjen zgjidhje ligjore çdo situatë konkrete në të cilën mund të gjendet autoriteti publik, ndaj edhe miratimi dhe zbatimi i procedurave të veçanta ad hoc jashtë përcaktimeve të këtij ligji, përbën një pengesë serioze në rrugën e integritimit evropian.

Mësime të vlefshme për rregullimin e së ardhmes në fushën e ligjeve/VKM-ve speciale duhet të shërbejë vendimi i Gjykatës Kushtuese për të ashtuquajturin ligj special "Për ndërtimin e Teatrit Kombëtar". Me një rrugë dhe kohëzgjatje procedurash unike në llojin e vet si nga ekzekutiviashtu edhe nga Kuvendi, përmbajta e ligjit special iu nënshtrua gjykimit kushtetues që e konstatoi atë në kundërshtim me Kushtetutën, për më shumë se një argument. Natyrisht që prej këtij vendimi mund të nxirren një sërë mësimesh dhe hapash të vlefshëm se si nuk duhet dhe sesi duhet vepruar.

Në vlerësojmë se një nga mësimet e para që duhet të jetë praktikë pune është vetë frenimi, vetë frenimi i Këshillit të Ministrave dhe i Kuvendit për të nxjerrë procedura përjashtuese jashtë rregullit të përgjithshëm. Nëse këtë vetë frenim nuk mund ta realizojmë - dhe me të drejtë

brenda kësaj sale mund të ketë shumë njerëz që në mënyrë të logjikshme argumentojnë se pse

kjo nuk ka shans të ndodhë – atëherë duhet të përcaktojmë mekanizma ligjore të fortë që përjashtimi të mos bëhet rregull i përgjithshëm.

- Shqipëria ka përveç bazës së nevojshme ligjore ka të plotësuar edhe kuadrin strategjik në prokurime nëpërmjet strategjisë përkatëse 2020-2023. Në këtë strategji përcaktohen në mënyrë të qartë objektivat dhe rrugët që do të ndiqen për zhvillimin e kësaj fushe dhe të operatorëve të përfshirë deri në fund të vitit 2023. Mbetet sfida realizimi i saj dhe veçanërisht ndjekja e të gjithë hapave dhe plotësimit të detyrave në kohë.

Prokurimi publik është një prej aspekteve të jetës dhe realitetit shqiptar. Ndaj ai i nënshtrohet një lloji rregullave të përgjithshme të vlerësimit që bëhen sot për shtetin dhe shoqërinë shqiptare.

Dhe në rrugën e integritimit evropian ka një fjali të përsëritur dhe që në rrugëtim është bërë postulat "Keni ligje të mira, por sfidoheni në zbatimin e tyre". Ndaj edhe zbatimi i drejtë dhe i plotë i ligjit, prokurimi publik këtu i përfshirë, mbetet çelësi i një rrugëtimi të suksesshëm evropian të Shqipërisë.



**ANEKS 1 – Dallimet mes Aktit Normativ nr. 9/2019 me ligjet 2006 dhe 2020 “Per prokurimin publik”<sup>24</sup>**

KONSTATIME	AKTI NORMATIV nr. 9	LIGJI nr. 9643/2006	LIGJI nr. 162/2020
<p>Ligji i Prokurimit Publik është një ligj organik që normon të gjitha prokurimet publike për mallra shërbime apo punë publike. Miratimi i normave dhe rregullave të posaçme për prokurimin e mallrave, punëveapo shërbimeve, në rastin konkret është e tepërt pasi, si Ligji nr. 9643 (i cili ishte në fuqi në periudhën e miratimit të Aktit Normativ nr. 9 ashtu edhe Ligji nr. 162/2020 kanë të përcaktuar në mënyrë të qartë dhe shteruese edhe procedura prokurimi në raste emergjente (siç mund të jetë Situata e Fatkeqësisë Natyrore).</p> <p>Vlen të përmendim këtu procedurën me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës, e cila në thelb është parashikuar nga ligjvënësi si procedura e prokurimit e cila përdoret nga autoriteti kontraktues për rastet emergjente.</p> <p>Si konkluzion, mund të themi se si Ligji nr. 9643 në fuqi në kohën e miratimit të aktit normative nr. 9, ashtu edhe Ligji nr. 162/2020 kanë të parashikuara në mënyrë shteruese procedurat e prokurimit që përdoren nga autoriteti kontraktues për rastet emergjente.</p>	<p><b>Neni 40</b> parashikon përcaktimin e rregullave të posaçme që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve.</p>	<p><b>Neni 1.</b> Objekti dhe qëllimi parashikon përcaktimin e rregullave qëzbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve ngaautoritetet kontraktore.</p>	<p><b>Neni 1.</b> Objekti përcakton rregullat për procedurat e prokurimit nga autoritetet dhe entet kontraktore për kontratat publike dhe konkurset e projektimit.</p>

<sup>24</sup>Ibid, page 15.



<p>Përcaktimi i një procedure të përshpejtuar në Aktin Normativ nr. 9, e më tej akoma përcaktimi me VKM nr. 199, datë 04.03.2020 i <b>Procedurës konkrete të Prokurimit të Kufizuar (procedure me dy faza) ndikon drejtpërdrejtë nxitjen e në konkurrencën e operatorëve ekonomikë dhe për të marrë pjesë në procedurë.</b></p> <p>Nga ana tjetër, Ligji Organik i Prokurimit Publik si i vjetri ashtu edhe Ligji i ri parashikojnë në mënyrë të qartë rastet kur se mund të përdoret kjo lloj procedure dhe kryesisht kur mallrat, punët apo shërbimet kanë karakter të ndërlikuar, është ekonomikisht më e leverdisshme për autoritetin kontraktues të shqyrtojë fillimisht kapacitetet teknike të kokurruesve apo kur kemi të bëjmë me kontrata komplekse. Në rastin konkret po prokurohen kryesisht ndërtime (banesa dhe objekte arsimore) dhe natyra e prokurimit në raport me gjendjen e tregut shqiptar të kompanive që operojnë në fushën e ndërtimit është shumë e favorshme.</p> <p>Gjithashtu, nga verifikimi i ofertave dhe kontratave të nënshkruara deri më tani në kuadër të procesit të rindërtimit rezultojnë që ofertat janë pothuajse sa 100% e fondit limit dhe kjo automatikisht provon faktin se kjo lloj procedure nuk ka nxitur pjesëmarrjen apo konkurrencën ndërmjet Operatorëve Ekonomikë.</p>	<p><b>Neni 42</b> Procedura e prokurimit publik për rindërtimin, pika 6, përcakton se:</p> <p>“Njësia zbatuese përdor procedurën e përshpejtuar, sipas përcaktimeve të këtij akti, për përzgjedhjen e fituesve të marrëveshjes kuadër për procesin e rindërtimit.</p> <p>VKM nr. 199 datë 04.03.2020 Këshilli i Ministrave ka miratuar dokumentat standarte të tenderit Tip, ku në pikën 4.1 të tyre përcaktohet se Lloji i Procedurës së Prokurimit do të jetë <b>Tender i Kufizuar në kuadër të Procesit të rindërtimit.</b></p>	<p><b>Neni 30</b> përcakton se <b>Procedura e hapur është procedura e preferuar në prokurimet.</b></p> <p><b>Neni 31</b> Procedura e kufizuar përcakton se</p> <p>1. Procedura e kufizuar përdoret nga autoriteti kontraktor për të kryer një prokurim që çon në dhënien e ndonjë kontrate publike, kur:</p> <p><b>a) malli, shërbimi ose puna përkatëse për shkak të karakterit të tij/ tyre shumë të ndërlikuar ose të veçantë mund të furnizohen sigurohen ose ekzekutohen nga operatorë ekonomikë të cilët kanë kapacitetin e duhur teknik, profesional ose financiar;</b></p> <p><b>b) është ekonomikisht më e leverdisshme për autoritetin kontraktues, fillimisht të shqyrtojë kapacitetin dhe kualifikimet e operatorëve të interesuar ekonomikë dhe më pas të ftojë ata që kanë kualifikimet minimale specifike të caktuara të paraqesin ofertat.</b></p>	<p><b>Neni 42</b> Procedurë e hapur përcakton se 1. <b>Procedura e hapur është procedurë me një fazë, ku mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar.</b></p> <p>VKM nr. 285 datë 19.05.2021 Rregullat e Reja të Prokurimit Publik, Neni 48 Procedura e kufizuar, përcaktojnë se:</p> <p>1. Procedura e kufizuar, sipas nenit 43, të LPP-së, është procedurë prokurimi me dy faza, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor që prokuronpunë/shërbime/mallra, në të cilën mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar.</p> <p>2. <b>Autoriteti/enti kontraktor në përzgjedhjen e kësaj procedure duhet të mbajë parasysh:</b></p> <p><b>a) kompleksitetin e objektit të kontratës;</b></p> <p><b>b) gjendjen e tregut;</b></p> <p><b>c) numrin e pritshëm të ofertuesve.</b></p>
---	--	--	---



<p>Afatet e shkurtuara për pranimin e ofertave nga ana e operatorëve ekonomikë, e ka kufizuar në mënyrë drastike konkurrencën, pasi është pothuajse e pamundur të përgatitësh një set të madh dokumentesh për një periudhë 10 ditore.</p> <p>Gjithashtu afati 10 ditor i përjashton “de facto” ofertat e operatorëve të huaj. Vlen të përmendim këtu se një operator i Huaj ka detyrimin që dokumentacion zyrtar ta paraqisi me vulë apostille.</p>	<p><b>Neni 42</b> Procedura e prokurimit publik për rindërtimin, pika 8, përcakton se Dokumentacioni dorëzohet në sistemin e prokurimeve elektronike.</p> <p><b><u>Afati kohor për pranimin e dokumentacionit është 10 ditë kalendarike nga data e publikimit të njoftimit.</u></b></p>	<p><b>Neni 43</b> Afatet kohore për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe për dorëzimin e ofertave, pika 2 përcakton se: Në procedurën e hapur, me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, <b>afati për paraqitjen e ofertave është jo më pak se 52 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik.</b></p>	<p><b>Neni 42</b> Procedurë e hapur, pika 2 përcakton se: <b>2. Për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati minimal për pranimin e ofertave është jo më pak se 35 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës.</b></p>
<p>Afati 2 ditë për ankimin ndaj kriterëve të procedurës së prokurimit, i përcaktuar në Aktin Normativ nr. 9 është jashtëzakonisht kufizues për operatorët ekonomikë të cilët mund të ngrejnjë pretendime për kriteret kualifikimi jo ligjore. Sqarojmë faktin se janë pikërisht kriteret e kualifikimit ato të cilat krijojnë premisa/incentiva apo e pamundësojnë pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi.</p> <p>Nga ana tjetër, edhe afati 3-ditor i trajtimit të ankesës nga ana e Komisionit të prokurimit Publik është tërësisht jo – objektiv. Në ligjin nr. 9643 afati i trajtimit të ankesës është 15 ditë ndërsa Ligji nr. 162/2020 është 30 ditë.</p> <p>Përcaktimi i këtij afati kaq të ngushtë cënon në mënyrë të drejtpërdrejtë dy nga parimet e vetë Aktit Normativ nr. 9 dhe konkretisht:</p> <p>1) trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë;</p> <p>ç) integritetin, besimin publik dhe transparencën.</p>	<p><b>Neni 42</b> Procedura e prokurimit publik për rindërtimin, pika 9, përcakton se:</p> <p>Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit operatorët ekonomikë <b>ankohen brenda 2 ditëve nga publikimi i dokumenteve të tenderit në Komisionin e Prokurimit Publik (KPP), qëshqyrton ankesën dhe merr vendim brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe këtij akti.</b></p>	<p><b>Neni 63</b> Të drejtat e personit të interesuar, pika 1.1 përcakton se:</p> <p>Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të <b>ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të APP. Pika 9 parashikon se: KPP merr vendim, jo më vonë se 15 ditë pas marrjes së info apo dok të kërkuar.</b></p>	<p><b>Neni 110</b> Afatet për Ankim përcakton se:</p> <p>1. <b>Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar</b>, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të <b>ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.</b></p> <p><b>Neni 115</b> “Trajtimi i ankesës nga KPP”, pika 4 përcakton se:</p> <p>Për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, KPP merr vendim jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së informacionit apo dokumentacionit nga autoriteti ose enti kontraktor.</p>



<p>Edhe kwtu Ligjvënësi ka shkurtuar afatet e vlerësimit të ofertave me 5 ditë dhe duke marrë në konsideratë faktin se kryesisht procedurat e prokurimit që zhvillohen në bazë të aktit normativ nr. 9 janë procedura mbi kufirin e lartë monetar, dhe kanë volum dokumentacioni atëhere afati 10 ditor i vlerësimit të ofertave e vë në vështirësi serioze cilësinë e vlerësimit dhe mundësinë e verifikimit objektiv të të gjithë dokumentacioni t të paraqitur nga ofertuesit. Edhe me këtë përcaktim janë cënuar dy nga parimet e Aktit Normativ nr. 9 dhe konkretisht:</p> <p>1) trajtimin e barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë;</p> <p>ç) integritetin, besimin publik dhe transparencën.</p>	<p><b>Neni 42</b> Procedura e prokurimit publik për rindërtimin, pika 9, përcakton se: <b>Pas afatit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje, siç përcaktohet në njoftimin e kontratës, AK përzgjedh kandidatët brenda 10 ditëve kalendarike.</b> Kundër vendimit të AK për përzgjedhjen e kandidatëve paraqitet ankim administrativ pranë KPP-së, brenda 3 ditëve nga njoftimi i kandidatëve fitues. KPP-ja shqyrton ankesën dhe merr vendim brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të ankesës.</p>	<p><b>Ligji nr.9643</b> nuk parashikonte asnjë afat të vlerësimit të ofertave, ndërsa VKM nr. 914 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e nxjerrë në zbatim të Ligjit 9643, në nenin 66, pika 2 parashikonte se:</p> <p><b>Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla.</b></p>	<p><b>Ligji nr. 162/2020</b> nuk parashikon afat për vlerësimin e ofertave, ndërsa VKM 285 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 82 Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave parashikon se:</p> <p>1. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë <b>20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar</b>, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla.</p>
<p>Edhe te vlera e sigurimit të kontratës e cila është parashikuar në masën 5% më e lartë në Aktin Normativ krahasuar me Ligjin nr. 9643 dhe ligjin nr. 162/2020, vërehet një hap pas dhe diskriminim të operatorëve ekonomikë që konkurojnë dhe nënshkruajnë procedura të përshpejtuara, në raport me operatorët ekonomikë që konkurojnë apo përzgjidhen fitues në procedura normale prokurimi.</p> <p>Përsëri me këtë parashikim ligjor cënohet një nga parimet e Aktit Normativ nr. 9 dhe konkretisht: Parimi i trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë;</p>	<p><b>Neni 43</b> Lidhja e kontratave pas marrëveshjes kuadër, pika 4, përcakton se: “4. Menjëherë, por në çdo rast jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së ofertës fituese, autoriteti kontraktor fton operatorin fitues të lidhë kontratën.<b>Përpara nënshkrimit të kontratës, operatori ekonomik fitues duhet t’i dorëzojë autoritetit kontraktor një sigurim kontrate prej 15% të vlerës së saj.</b></p>	<p><b>Ligji nr. 9643</b> nuk parashikon masë sigurimi kontrate, ndërsa VKM 914 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 24 Sigurimi i kontratës përcakton se: “Sigurimi i kontratës garanton autoritetin kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. <b>Para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i përzgjedhur si fitues duhet t’i dorëzojë autoritetit kontraktor një sigurim kontrate prej 10% të vlerës së saj.</b></p>	<p><b>Ligji nr. 162/2020</b> nuk parashikon masë sigurimi kontrate, ndërsa VKM 285 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 36-Sigurimi i kontratës përcakton se:</p> <p>1. Sigurimi i kontratës garanton autoritetin/entit kontraktor në rastet e shkeljes së kontratës. <b>Para nënshkrimit të kontratës, ofertuesi i përzgjedhur si fitues duhet t’i dorëzojë autoritetit/entit kontraktor një sigurim kontrate prej 10% të vlerës së saj.</b></p>



## ANEKS 2 – Procedura të Kufizuara (Programi i Rindërtimit) dhe Negocime pa Shpallje në vitet 2020 dhe 2021, Numër Procedurash dhe Vlerë Fondi Limit i Tenderuar (pa anulimet)<sup>25</sup>

	2021	2020
Fond Limit Total Procedura Prokurime (në Lek pa TVSH)	147.774.069.034	267.765.243.763
Fond Limit Procedura të Kufizuara (Procesi i Rindërtimit) në Lek pa TVSH	19.333.466.996	69.164.367.246
Procedura të Kufizuara (Rindërtimi)	137	108
Procedura të Kufizuar Lokale (Rindërtimi)	134	92
Procedura te Kufizuara Nderkombetare (Rindërtimi)	3	16
Negocim Pa Shpallje	244	504
Totale Fond Limit Negocim pa Shpallje (ne Lek pa TVSH)	4.881.668.882	6.968.096.300
Pesha kundrejt Totalit Nr Procedure e Kufizuar	0,8%	0,58%
Pesha % Fond Limit Prokruar me Procedurë të Kufizuar vs. Totalit	<b>13,1%</b>	<b>25,8%</b>
Pesha kundrejt Totalit Negocime pa Shpallje	1,4%	2,7%
Pesha % Fond Limit Negocim Pa Shpallje Kundrejt Totalit	3,3%	2,6%
Fond Limit Negocim pa Shpallje plus Procedure e Kufizuar	24.215.135.878	76.132.463.546
Pesha % Fond Limit Negocim pa Shpallje plus Procedure e Kufizuar	<b>16,4%</b>	<b>28,4%</b>
Numër Total Procedurash të PaAnulluara	<b>17.400</b>	<b>18.540</b>

<sup>25</sup>Public Procurement Agency, *Export of Data on Procurement Procedures*, <http://app.gov.al/eksportimi-i-procedurave-te-publikuara/>





## REFERENCA

1. European Commission, *Public Procurement - Current Legal Framework, Rules, Thresholds and Guidelines*, [https://ec.europa.eu/growth/single-market/public-procurement/legal-rules-and-implementation\\_en](https://ec.europa.eu/growth/single-market/public-procurement/legal-rules-and-implementation_en)
2. Public Procurement Agency, Law no. 9643, dated 20.11.2006, "On public procurement", as amended, <https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=5a6fa8ae-6fec-48bc-bdf1-bc419c0b4734>
3. Concentrated Purchasing Agency, no. 81 dated 14.2.2018, "On the establishment, organization and functioning of the Concentrated Purchasing Agency", <http://abp.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/VKM-nr.-81-date-14.2.2018.pdf>
4. Public Procurement Agency, DCM no. 82, dated 14.2.2018, "On authorizing the Concentrated Purchasing Agency for conducting public procurement procedures in the name and on behalf of the Prime Minister's Office, ministries and subordinate institutions, for certain goods and services", <https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=b40d686d-8b11-4235-9237-d6a76106b204>
5. Concession Treatment Agency, Law 125/2013, "On concessions and public private partnership", as amended, [http://atrako.gov.al/wp-content/uploads/2015/09/Ligji-Nr.125\\_2013-p%C3%ABrdit%C3%ABsuar.pdf](http://atrako.gov.al/wp-content/uploads/2015/09/Ligji-Nr.125_2013-p%C3%ABrdit%C3%ABsuar.pdf)
6. Official Journal, DCM no.280, dated 7.4.2020 "On the approval of the regulation on the functioning of the selection committee for concession/PPP projects and the criteria for evaluating the requests of contracting authorities for support with specialized expertise", <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/04/07/280>
7. Official Journal, DCM no.285, dated 10.4.2020 "On the organization and functioning of the Concession Treatment Agency", <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/04/10/285/5075cdd9-37f4-483b-8030-c3f04652f9b7>
8. Public Procurement Agency, Law no. 9643, dated 20.11.2006, "On public procurement", as amended, <https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=5a6fa8ae-6fec-48bc-bdf1-bc419c0b4734>
9. Public Procurement Agency, Law no. 9643, dated 20.11.2006, "On public procurement", as amended, <https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=5a6fa8ae-6fec-48bc-bdf1-bc419c0b4734>
10. European Commission, *Albania Country Report 2019*, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2019-07/20190529-albania-report.pdf>
11. European Commission, *Albania Country Report 2018*, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/20180417-albania-report.pdf>
12. Albanian Parliament, *Assessment Report on the draft-law "On Public Procurement"*, <https://parlament.al/Files/ProjektLigje/20200907142101RELACION%20-%20PROKURIMI%20PUBLIK.pdf>





13. European Commission, *Albania Country Report 2021*, [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en)
14. Public Procurement Agency, *Public Procurement Strategy 2020-2023*, <https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=4b54d140-e98b-434b-abfb-d3966453b8dd>
15. The Court of Justice of the European Union, *C-462/99, Connect Austria Gesellschaft für Telekommunikation GmbH v. Telekom-Control-Kommission*, 22 May 2003, § 84, <https://curia.europa.eu/juris/showPdf.jsf?text=&docid=102229&pageIndex=0&doclang=en&mode=req&dir=&occ=first&part=1&cid=7447426>
16. Minister of State of Reconstruction, Normative Act no. 9, dated 16.12.2019 "On coping with the consequences of natural disasters", [https://rindertimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/02/akt-normativ-2019-12-16-9\\_Per-perballimin-e-pasojave-te-fatkeqesise-natyrore.pdf](https://rindertimi.gov.al/wp-content/uploads/2020/02/akt-normativ-2019-12-16-9_Per-perballimin-e-pasojave-te-fatkeqesise-natyrore.pdf)
17. Constitutional Court, *Final Decisions*, Decision no.29 dated 02.07.2021 [https://www.gjk.gov.al/web/Vendime\\_perfundimtare\\_100\\_1.php](https://www.gjk.gov.al/web/Vendime_perfundimtare_100_1.php)
18. The Parliament, Law no. 37/2018 "On determining a special procedure for negotiating and signing a contract for the "Design and implementation of the urban project and the new building of the National Theater" <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20180926123505ligje%20nr,%2037,%20dt.%2020.9.2018%20I%20rishikuar,%20i%20rivotuar.pdf>
19. The Parliament, *Presidential Decree No. 10849*, dated 27.07.2018 on the review of law no. 37/2018, <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20180903113228dekret%2010849.pdf>
20. The Parliament, *Presidential Decree No. 10908* on the review of law no. 37/2018, <https://www.parlament.al/Files/LigjeRishqyrtim/Dekreti%20nr%20%2010908.pdf>
21. Albanian Institute of Science, *Repeal of Chapter VI, PUBLIC PROCUREMENT PROCEDURES*, articles 40 - 44, and article 4, point 7 and point 9, of the normative act with the force of law no. 9, dated 16.12.2019 "On coping with the consequences of natural disasters", approved by the Assembly of Albania with law no. 97/2019, on 18.12.2019, [https://ndiqparate.al/wp-content/uploads/2021/09/AIS-Gjykatën-Kushtetuese\\_bilingual-2.pdf](https://ndiqparate.al/wp-content/uploads/2021/09/AIS-Gjykatën-Kushtetuese_bilingual-2.pdf)
22. Agency for Public Procurement, *Annual Analyses 2020*, <https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=7df293d1-1577-49f6-9bd8-199e00bcf7b0>
23. Public Procurement Agency, *Export of Data on Procurement Procedures*, <http://app.gov.al/eksportimi-i-procedurave-te-publikuara/>

